



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 22.9.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Berat Luzha, Ali Lajçi, Selvie Halimi.

Munguan : Zef Morina, Dragiša Mirić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Kujtim Aliu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i raportit për monitorim të Ligjit për Mbeturina,
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet,
3. Caktimi i grupit punues për projektligjin e radhës.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i Raportit për Monitorimin e Ligjit për Mbeturina

Kryesuesi Lulzim Zeneli konstatoi se dy takimet e fundit në komision kanë qenë dëgjime publike, nga të cilat janë hartuar transkriptet dhe të cilat nuk i nënshtrohen votimit nga komisioni, pastaj pyeti të pranishmit për ndonjë vërejtje eventuale për raportin e draftuar nga stafi dhe përfaqësuesi i OSCE, duke u fokusuar në faqen 17 për rekomandimin rreth KMDK, e cila si zyre qendrore për kompanitë publike e arsyeton ekzistimin apo jo dhe si duhet të rekomandoi komisioni për këtë kompani e cila është në mbikëqyrjen e MEF, të zhvendoset në MMPH apo ndonjë sugjerim tjetër.

Naim Maloku dhe **Zylfi Merxha** u pajtuan që raporti i ofruar të përcjellët seancës plenare për miratim ngase i përmbush kushtet elementare, me propozim që kjo pikë e theksuar rreth KMDK të hiqet nga raporti sepse thjeshtë deponitë janë asete të Qeverisë, ndaj ky komision sa mundet dhe sa ka fuqi që të propozoi lidhur me statusin e kësaj kompanie, është pikëpyetje. **Lulzim Zeneli** u bashkëngjiti diskutimit duke propozuar që për këtë kompani dhe deponitë rajonale duhet të hartohet Ligji i veçantë.

Elheme Hetemi kërkoi disa sqarime paraprake rreth licencimeve të kompanive private sipas kërkesave në disa komuna, a duhet të licencohen apo jo sepse ato krijojnë konkurrencë-kualitet më të lartë, për çka ajo mendon se duhet të diskutoi Kuvendi, por sipas vlerësimit të komisionit ky shqetësim nuk kishte të bëjë me statusin e kompanisë në fjalë, për çka parashtroi sugjerimin kryetari. Ajo më vonë edhe një herë u bashkëngjiti diskutimit tha se komisioni nuk mund të propozoi ndalimin e ekzistimit të KMDK ngase Ligji i ndërmarrjeve publike lejon ekzistimin e kësaj kompanie, dhe do të krijohej një kolizion i kompetencave në mes ZRRUM , rreg. së UNMIK-ut dhe këtyre kompanive.

Berat Luzha mendon se kjo kompani për shkak të kompetencave mjedisore duhet të bartet në MMPH ngase aty e ka vendin, si dhe vlerësoi se kemi të bëjmë me një kompani të dështuar gjë që arsyeton edhe mosekzistimin. Megjithatë propozoi të mbetet rekomandimi në mënyrë që të diskutohet në Kuvend rreth problematikës që sjellë kjo kompani, të demonopolizohet si kompani publike sepse të gjitha kompanitë publike janë asete të Qeverisë, të kërkohet sqarim çfarë funksioni ka, etj të cilat pyetje mund të rregullohen me hartimin e ligjit ose ndoshta edhe me UA.

Lulzim Zeneli vërejti se ndoshta do të ishte më mirë komisioni të autorizohet nga seanca plenare për rekomandim të këtij komisioni rreth KMDK dmth Kuvendi të jap autorizimin komisionit të sugjeroi lidhur me këtë kompani.

Blerim Vela propozoi përmirësimin e dy rekomandimeve dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e parashtruara këtu.

Kryetari formuloi kërkesat e përbashkëta të komisionit i cili nxori :

P Ë R F U N D I M

Fshihet pika e fundit e rekomandimeve të propozuara rreth KMDK dhe raporti i dërgohet Seancës Plenare për miratim.

Statusi i KMDK duhet të rregullohet me ligjin e veçantë për çka i adresohet përgjegjësisë së Qeverisë.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet

Lulzim Zeneli fillimisht njoftoi komisionin me përgjigjen përkatësisht kërkesën e përfaqësuesve nga 6 Komunitat e Kosovës pas dëgjimit publik të mbajtur :

- të ekzistojnë dy nivele të menaxhimit me pyje, ai qendror i cili do të hartoi politikat e menaxhimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, ndërsa ai lokal do të zbatoi këto politika,

- të shuhet APK, dhe

- Komunitat të qeverisin me të gjitha asetet e ish ekonomive pyjore.

Në vazhdim ai sugjeroi të formohet GP ose përndryshe diskutimet do të zgjatnin tepër.

Naim Maloku nuk kundërshtoi formimin e GP dhe tha se grupi duhet të bashkëpunoi me Ministrinë për shkak të harmonizimit të qëndrimeve deri të premtën.

Berat Luzha tha se është skeptik lidhur me projektin kozmetik të propozuar ngase nuk precizohen kompetencat dhe për këtë arsye nuk dihet çka do të ofrojnë komunitat e çka ministria, për këtë arsye ai propozoi hartimin e ligjit të ri nga ky komision. Ai potencoi sidomos faktin e uzurpimit të kompetencave nga APK të cilat i takojnë Departamentit të MB për Pyje, poashtu me këtë projekt abstrahohen kompetencat e Drejtorive Komunale.

Elheme Hetemi ishte e dyshimtë për nevojën e hartimit të ligjit të ri nga komisioni ngase megjithatë kemi të bëjmë me pasuri nacionale e cila duhet të mbrohet edhe nga organet qendrore, ndaj ajo mendon se grupi punues duhet të definoi bashkërisht me MB kompetencat për pyje.

Myrvete Pantina u pajtua me Elhemen dhe njoftoi komisionin për takimin me përfaqësuesin e FAO sipas autorizimit të kryetarit, i cili i ka ofruar komisionit strategjinë për pyje dhe i cili ka theksuar se ligji ekzistues për Pyje nuk është i keq, por duhet të zbatohet.

Berat Luzha u angazhua edhe për një dëgjim publik se çka mendojnë komunat, mirëpo u dëgjuan disa deputet (Naim Maloku etj) se tanimë janë dërguar përgjigjet nga 6 komunat që janë me rëndësi të veçantë.

Selvie Halimi tha se problemi kryesor qëndron tek zbatimi i ligjeve, jo vetëm të këtij, ndaj kërkohet vetëm punë konkrete dhe të arrihen rezultate. Ajo ishte për themelimin e GP për ndërhyrje të duhura, ngase hartimi i ligjit të ri do të vonoj tepër. Për strategjinë e cila u sugjerua nga Myrvetja përkatësisht përfaqësuesi i FAO-së, tha se duhet paraprakisht të miratohet nga Kuvendi.

Heset Cakolli nuk u pajtua për hartimin e ligjit të ri, ngase më e arsyeshme do të ishte të punoi GP bashkërisht me MB, pastaj në fund komisioni të vlerësoi punën e grupit.

Naim Maloku vlerësoi angazhimin e Berat Luzhës në tre legjislacione lidhur me ligjin e Pyjeve dhe theksoi se problemi qendror është pse me këtë projekt do ti delegohen kompetencat disa komunave e disave jo, ai mendon se disa komunave nuk do t'ju delegohen këto kompetenca për shkak të mungesës së kapaciteteve të tyre, ndaj propozoi që GP të sqaroi çështjet në këtë drejtim :

- cilat kompetenca do të barten komunave dhe cilat komuna janë ato që do ti kenë këto kompetenca,

- a do të shuhet APK,

- çka propozohet me ish ekonomit pyjore.

Elheme Hetemi kësaj radhe shprehu dyshimin për shuarjen e APK, sepse sipas një modeli tjetër nga projekti i Freedom-it në ministri, pikërisht Departamenti pyjor është ai që duhet të shuhet, megjithatë u pajtua se duhet të qartësohen gjërat me zyrtarët e MB.

Berat Luzha tha se APK është organ ekzekutiv dhe asgjë më tepër, ndërsa politikat i krijon departamenti pyjor të cilat i ka uzurpuar APK.

Ali Lajçi tha se angazhimi i GP duhet të drejtohet në atë mënyrë që poçes 50% të kërkesave janë të arsyeshme, atëherë duhet të ndryshoi edhe ligji, nëse jo atëherë të vazhdohet me GP. Duhet poashtu, vazhdoi, të eliminohen termet e vjetra siç është “niveli rajonal” dhe të saktësohen dy nivele, qendror dhe ai lokal me kompetenca të saktësuara.

Lulzim Zeneli ju rikujtoi deputetëve se Muzafër Luma gjatë dëgjimit publik ka thënë “komunat kanë kërkuar dhe ne tani po ju delegojmë kompetencat komunale pyjore”, ndaj propozoi që GP të shqyrtoi se çka mbetet për komuna e çka për nivelin qendror sa i përket kompetencave për menaxhimin me pyje.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Formohet Grupi punues e përbër nga Berat Luzha, Elheme Hetemi dhe Zef Morina që bashkërisht me zyrtarër e ministrisë së bujqësisë të hartojnë vërejtjet eventuale në projektligjin për ndryshimin e Ligjit për pyje duke u fokusuar në kompetencat lokale dhe qendrore sa i përket menaxhimit me pyjet e Kosovës, i cili grup punues do të takohet të enjten më 24.9.2009 në orën 13,00 për të përgatitur sugjerimet për mbledhjen e radhës më 29.9.2009.

3. Caktimi i grupit punues për projektligjin e radhës dhe të ndryshme

Lulzim Zeneli propozoi grupin punues për projektligjin e radhës dhe hapi diskutimin rreth obligimit ligjor të MMPH rreth përgatitjes së dokumentit për vlerësim strategjik në bazë të nenit 21 të ligjit për VSM për projektet siç janë termocentrali, autostrada etj.

Naim Maloku ishte i mendimit që rreth temës së termocentralit etj mos të hapet debati së paku deri më 15 nëntor për shkak të zgjedhjeve që do të mbahen, mirëpo **Lulzim Zeneli** tha se këtë dokument për vlerësim strategjik është i obliguar MMPH ta dërgoj në Kuvend sipas ligjit për VSM.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Formohet Grupi punues e përbër nga Selvie Halimi, Heset Cakolli dhe Myrvete Pantina për hartimin e vërejtjeve eventuale rreth projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me mbështetjen e përfaqësuesve të OSCE.

Për mbledhjen e dt. 6.10.2009 ftohet Ministri i MMPH në dëgjim parlamentar në komision rreth termocentralit “Kosova e Re” duke sjell edhe dokumentin e VSM për këtë projekt, të cilin dokument MMPH duhet ta dërgoi komisionit një javë më parë, konform nenit 21 të Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM).

Elheme Hetemi ngriti çështjen e vizitës së kërkuar nga Kryesia e Kuvendit në bazë të takimit të mbajtur me zyrtarët nga Wiskonsin të SHBA, mirëpo sqarimi i Lulzim Zenelit dhe Naim Malokut ishte se ka qenë deshtë së pari komisioni të mbështet këtë kërkesë pastaj të veprohet sipas procedurës parlamentare.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet më 29.9.2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli